



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 189/7Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

V E N D I M

Nr. 77, Datë 30.06.2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL FIER “MBI
PËRPUTHSHMËRINË (PAJTUESHMËRINË) DHE RREGULLSHMËRINË”
Për periudhën nga data 20.02.2018 deri me datë 20.04.2018.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë” të ushtruar në Spitalin Rajonal Fier për veprimtarinë nga data 01.04.2016 deri me datë 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:

1.1. Gjetje nga auditimi: Mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë të Spitalit Rajonal Fier, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre është me status të pa përcaktuar. Konkretisht:

Spitali Rajonal Fier është person juridik publik dhe organizohet, administrohet dhe vepron sipas Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, si edhe të gjitha ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore për shërbimin spitalor dhe kujdesin shëndetësor.

Në mbështetje të këtij ligji, ky spital kategorizohet *de jure* si spital rajonal (spital qarku) dhe emërtimi specifik i tij është “Spitali Rajonal Fier”. Organet drejtuese të autoritetit spitalor të qarkut duhet të jenë 1. Këshilli Administrativ; 2. Drejtoria; 3. Komisioni mjekësor. Ndërkohë që faktikisht në këtë qendër funksionon vetëm Drejtoria, ndërsa organet kolegjiale Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor nuk funksionojnë.

Drejtoria sipas përcaktimeve në ligj është e përbërë prej 1. Drejtori ekzekutiv; 2. Zëvendësdrejtori teknik 3. Zëvendësdrejtori ekonomik; 4. Kryeinfermieri i përgjithshëm. *De facto* titullari i institucionit nuk është drejtor ekzekutiv me të drejta dhe kompetenca të plota, pikërisht prej boshllëkut të krijuar strukturalist, për shkak të mungesës së organeve të përcaktuara në ligj, me të cilët janë të lidhura ngushtësisht detyrat ekzekutive të titullarit.

Neni 40 i ligjit parashikon: “*Pranë autoritetit spitalor publik të qarkut ushtron veprimtarinë e vet komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut, i cili është organi këshillimor i tij*”, në fakt një komitet i tillë nuk ekziston.

Në këto kushte është i pamundur përcaktimi konkret i statusit juridik të Spitalit Rajonal Fier. Për më tepër konfuziteti dhe hendeku i madh që ekziston mes referimit në ligj dhe asaj çfarë ndodh në përditshmërinë e aktivitetit spitalor provohet dhe me faktet si më poshtë:

-Kategorizimi i pagave të personelit administrativ dhe atij spitalor të kësaj qendre, e cila konsiderohet Spital Rajonal, është i njëjtë me të gjitha spitalet e tjera të bashkive të Qarkut të Fierit, Bashkia Fier, Bashkia Lushnje, Bashkia Mallakastër, Bashkia Divjake, Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec. Më konkretisht, titullari i institucionit (drejtori) baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 81,800 lekë, mjek i përgjithshëm baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 42,000 lekë, shef shërbimi baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 55,000 lekë, specialist i thjeshtë i administratës baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 34,200 lekë; etj.

-Transaksionet financiare të kryera nga Dega e Thesarit pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, emërtohen për llogari të Spitalit të Rrethit (Bashkisë) Fier. Pra, Spitali Rajonal Fier kategorizohet në të njëjtin rang juridik si spitalet e tjera të nivelit bashkiak.

-Struktura analitike, organizative dhe administrative, e cila vjen e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë është e njëjtë si për Spitalin Rajonal Fier që ligjërisht organizohet si Spital Rajonal, ashtu edhe për Spitalet e Qarkut të Fierit që organizohen si spitale bashkiake.

-Miratimi i tarifave të shërbimeve bëhet me urdhër të brendshëm të titullarit të Institucionit (Drejtori), në mungesë të Këshillit Administrativ; etj.

Bazuar në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, organi përgjegjës për njohjen, hapjen dhe klasifikimin e spitaleve publike, miratimin e strukturës organike, ofrimit të llojeve të shërbimeve spitalore, etj, është Ministria e Shëndetësisë, e cila duhet të bëjë një përcaktim juridik në lidhje me statusin juridik të spitaleve publike, përfshirë edhe Spitalin Rajonal Fier.

-Veprimtaria e administratës është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, që miratohet nga Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu dhe Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë të urdhërojë ushtrimin e kontrolleve të plota ose të pjesshme për veprimtarinë e Spitalit Rajonal Fier nëpërmjet strukturave të specializuara. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 15-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandimi:

-Drejtori i Spitalit Rajonal Fier, ti kërkojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instancave të tjera kompetente, përcaktimin konkret të statusit juridik që duhet të ketë ky Spital, në lidhje me funksionimin dhe aktivitetin e Tij.

Menjëherë

2. Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:

2.1. Gjetje nga auditimi:

Në 8 raste në vlerën 14,335,696 lekë janë kryer procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në rrethanat të veçanta (kushte specifike) të pa parashikuara nga dispozitat ligjore, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër, ngarkon me përgjegjësi Brunilda Çami me detyrë ish-drejtor i spitalit në cilësinë e titullarit të entit prokurues, i cili me veprimet dhe mosveprimet, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës.

-Në 4 raste në vlerën 5,791,166 lekë janë kryer procedura prokurimi të cilat nuk janë në kompetencën e Spitalit Rajonal Fier, por të Ministrisë së Brendshme, pra këto procedura janë kryer në tejkalim të kompetencës, veprim në kundërshtim me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e ministrisë së punëve të brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi B.Ç me detyrë ish-drejtor i spitalit në periudhën 30.03.2016 deri 14.06.2017.

-Në 8 raste, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

-Për 9 procedura prokurimi, në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

-Në 9 procedura prokurimi, specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Në 9 procedura prokurimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 24 raste, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në 6 raste për vlerën 5,697 mijë lekë, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë publike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Nga Drejtoria e Spitalit, procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të kryhen vetëm në rrethana të veçanta (kushte specifike) të përcaktuara në nenin 36/2/c, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar. Në asnjë rast tjetër nuk mund të legjitimohet përdorimi i kësaj procedure.

-Drejtoria e Spitalit, të mos kryej në asnjë rast procedura prokurimi të cilat nuk janë në kompetencë të Spitalit Rajonal Fier, në zbatim të VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e ministrisë së punëve të brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” i ndryshuar.

-Nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Titullari i Entit Prokurores, përlllogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në varësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj Spitalit, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e Ligjit për prokurimin publik, si dhe në rregullat e prokurimit publik.

-Nga drejtoria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e anulimit, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për

prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Në vijimësi

2.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u konstatua se në 8 raste operatorët ekonomik apo bashkimet e operatorëve nuk kanë zbatuar grafikun e lëvrimit të medikamenteve sipas kontratës, duke mos e përmbushur me sukses kontratën dhe duke vendosur Spitalin Rajonal Fier në vështirësi në përmbushjen me sukses të misionit të tij kryesor të shërbimit cilësor ndaj pacientëve, në kundërshtim me seksionet përkatëse në kontratat e medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për blerje medikamentesh. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Drejtorja e Spitalit Rajonal Fier të marrë masa që për të gjitha kontratat e lidhura për medikamente të monitorojë zbatimin e kontratave dhe afatin e lëvrimit të medikamenteve sipas përcaktimeve të bëra, si dhe në rast mos realizimi të kontratës me sukses të aplikojë penalitetet e përcaktuara në kontratë.

Në vijimësi

3. Nga auditimi i mbajtjes së evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:

3.1. Gjetje nga auditimi: Kontabiliteti i njësisë mbahet në program exel dhe nuk është përfshirë në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Veprimet për mbylljen e pasqyrave financiare janë kryer të ndara nga regjistrimet në ditarin veprimeve kontabël, nëpërmjet pasqyrimeve nga jashtë, për klasën 6 (pagat, kontributet, shpenzimet operative dhe mallrat, transfertat e brendshme dhe ndryshimi i gjendjes) dhe klasës 7 (të ardhurat nga shërbimet mjekësore dhe donacionet). Pra ato janë mbajtur në regjistër të veçantë, ekstra kontabël dhe në fund të periudhës janë pasqyruar në pasqyrat financiare. Organizimi i një sistemi të tillë pengon përdorimin e informacionit në kohën e duhur për çështje të vendimmarrjes dhe gjurmës së auditimit, si dhe nga ana tjetër rrit riskun e gabimeve gjatë mbartjes në regjistra fizike. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 14-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

Nga Drejtorja e Spitalit dhe Sektori i Financës të merren masa për mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike, duke përfshirë dhe sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit, të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike, të dhëna për raporte financiare dhe statistika, etj.

Në vijimësi

3.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarit të bankës u konstatua se:

- Shpenzimet për pagesën e Ujësjellësit janë debituar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ndërkohë që referuar klasifikimit kontabël duhet të debitohen në llogarinë 445 “Organizma të tjerë publik”. Saktësisht për muajin janar 2016 është debituar llogaria 467 për detyrimet e Ujësjellës Kanalizime për muajin dhjetor 2015 në vlerën 2,235,760 lekë, ndërkohë duhet të ishte debituar llogaria 4452 “Organizma të tjerë publik, të vitit të mëparshëm”.

E njëjta situatë për këtë muaj është në lidhje me detyrimet ndaj OSHEE, ku është debituar llogaria 467 në vlerën 2,051,630 lekë, ndërkohë duhet të ishte debituar llogaria 4452.

- Në muajin janar 2016, është debituar llogaria 467 për shpenzime dieta për muajin dhjetor 2015 në vlerën 47,000 lekë, ndërkohë duhet të ishte debituar llogaria 4282 “Personeli shpenzime për tu paguar, të vitit të mëparshëm”.

- Në muajin janar 2016, është debituar llogaria 467 për DRSHTRR Fier taksë vjetore për automjetin AA054KV në vlerën 1,166 lekë, ndërkohë duhet të ishte debituar llogaria 4452 “Organizma të tjerë publik, të vitit të mëparshëm”.

- Në muajin shkurt 2016, është debituar llogaria 467 për detyrimet e Ujësjellës Kanalizime dhe OSHEE për muajin janar 2016 në vlerën 1,873,942 lekë, ndërkohë duhet të ishte debituar llogaria 4451 “Organizma të tjerë publik, të vitit në vazhdim”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

-Në vijim Sektori i Financës të tregohet i kujdesshëm në reflektimin e shifrave të sakta (edhe pse në rastin konkret pa impakt material në rezultatin vjetor), në pasqyrat financiare, duke konsideruar rëndësinë që pasqyrat financiare kanë në procesin e vendimmarrjes, mbi shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve buxhetore.

-Nga Sektori i Financës të përcaktohet politika kontabël e ndjekur për regjistrimet e veprimeve kontabël, në përputhje me parimet e kontabilitetit aktual (rrjedhës), si dhe të kryhet unifikimi i metodës kontabël për të gjitha veprimet kontabël brenda vitit ushtrimor.

Në vijimësi

3.3. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Fier, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të asetëve në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përkatëse, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

-Të zbatohen procedurat ligjore nga Spitali Rajonal Fier, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

Në vijimësi

4. Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatua që:

4.1. Gjetje nga auditimi: Në një rast për vlerën 957,000 lekë për vitin 2017, shpenzimi buxhetor i kryer nuk është klasifikuar dhe regjistruar në mënyrë korrekte. Konkretisht shpenzimi për riparimin e grafisë kryer më datën 03.05.2017, është regjistruar në llogarinë 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, ndërkohë që duhet të ishte regjistruar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”. Ky shpenzim nuk duhet të ishte klasifikuar si investim, por si shpenzim. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7.

Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masa që, në çdo kohë, klasifikimi i shpenzimeve të kryhet sipas planifikimit buxhetor duke respektuar limitin e angazhuar për çdo llogari, si dhe kërkesat për domosdoshmërinë e shpenzimeve të jenë të mirë justifikuar dhe të mbështeten në statistikat dhe nevoja reale të institucionit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 18-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Në vijimësi

4.2. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste për vitin 2016 dhe në një 1 rast për vitin 2017, kontratat e lidhura me operatorët ekonomik nuk janë depozituar në afat në Degën e Thesarit Fier, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për zbatimin të Buxhetit”, pika 144. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 18-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masa që kontratat e lidhura me operatorët ekonomik, të dorëzohen në degën e thesarit jo më vonë se 3 ditë pas firmosjes, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për zbatimin të Buxhetit”, pika 144.

Në vijimësi

5. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:

5.1. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Spitalit Rajonal Fier është hartuar me datë 06.01.1998, dhe nuk përcakton me hollësi dhe saktësi të gjitha detyrat dhe funksionet e stafit të drejtorisë sipas strukturës aktuale të miratuar, konform Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

- Spitali Rajonal Fier, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar regjistrin ose raportin e përgjithshëm të risqeve.

- Nuk është realizuar deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar.

- Për vitet 2016 dhe 2017 nuk ka urdhër të Titullarit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS). *(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të marrë masa për hartimin e rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të institucionit, ku të implementohen sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Në kuadrin e zbatueshmërisë të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, i ndryshuar, të bëhen kualifikime e seminare për zberthimin e ligjit, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e MFK për të gjithë menaxherët, më qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

Në vijimësi

5.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm ka funksionuar në Spitalin Rajonal Fier, vetëm me 1 punonjës dhe vetëm për periudhën 08.07.2016 deri 07.02.2018. Ekzistenca e vetëm një punonjësi, i cili gjithashtu nuk rezultoi të jetë i certifikuar si auditues i brendshëm, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të paçertifikuar, si auditues të brendshëm në sektorin publik”. Për periudhën objekt auditimi janë hartuar plane auditimi, por nuk kanë gjetur asnjë zbatim dhe gjatë kësaj periudhe nuk rezultoi të jetë kryer asnjë auditim. Gjithashtu nuk ka asnjë gjurmë për funksionimin e kësaj njësie. Për pasojë, ekzistenca dhe funksionimi i kësaj njësie, ose më saktë në rastin konkret i audituesit të vetëm të brendshëm, nga ana e grupit të auditimit konsiderohet jo efektive. (Trajtuar më hollësisht në faqet 118-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga drejtoria të merren masa që në strukturën organizative, të jetë organizuar dhe të funksionojë Njësia Auditit të Brendshëm, në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Për aprovimin e manualit të procedurave të Auditit të Brendshëm, mbi Kodin e Auditit të Brendshëm dhe mbi Auditimin e Brendshëm Publik”, seksioni II, pika 8.

Në vijimësi

6. Nga auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj), u konstatua që:

6.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të urdhër pagesave u konstatuan disa mangësi, konkretisht:

1. Fletëhyrjet e magazinës janë të firmosura vetëm nga magazinieri.
2. Disa raste fatura tatimore janë të firmosura vetëm nga magazinieri.
3. Procesverbalet për pritjen, administrimin dhe dokumentimin e medikamenteve, janë pa specifikuar se cilat ishin specifikimet që duhet të plotësojnë bari (medikamenti) dhe pa u shprehur nëse ky i fundit i ardhur në institucion plotëson specifikimet teknike të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 25-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga Spitali Rajonal Fier të merren masa që barnat të merren në dorëzim nga grupe teknik me specialistë të fushës, duke hartuar akt kolaudime ku të përshkruajnë përputhjen ose jo të barit (medikamentit) me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

7. Nga auditimi i zbatimit të procedurave dhe dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, për periudhën objekt auditimi, u konstatua që:

7.1.Gjetje nga auditimi: Përdorim nga persona të tretë të aseteve të spitalit, të pa kontraktuar dhe pa vjelur detyrimin e qirasë, konkretisht personin fizik Fato Bubeqi. Spitali Rajonal Fier ka lidhur kontratën e qirasë nr. 525, datë 21.03.2013, me objekt dhënien me qira të hapësirës 30 m², me vlerë 5,400 lekë në muaj (30 m² x 180 lekë/m²), me afat 1 vit. Me mbarimin e afatit të kontratës, nga Spitali Rajonal Fier është lejuar që personi fizik Fato Bubeqi ta posedojë ambientin, pa nënshkruar më parë kontratë të re qiraje, në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 801-825, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 124-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

-Nga Drejtoria e Spitalit të merren masat që për ambientet e dhëna me qira, pas miratimit paraprak të Ministrit të Shëndetësisë, të lidhen kontratat përkatëse.

Në vijimësi

8. Nga auditimi i zbatimit të procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit, u konstatua që:

8.1 Gjetje nga auditimi. Sekretari i Drejtorit mbulon edhe detyrën e protokollit, si dhe arkivi është në varësi nga Sektori Ekonomiko Financiar dhe Administrativ, në kundërshtim me rregulloren e funksionimit të Spitalit Rajonal Fier, ku nuk përcaktohet funksioni i sekretarit dhe i protokoll/ arkivit. (Trajtuar më hollësisht në faqet 128-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga drejtoria të merren masa për hartimin e rregullores së brendshme të Spitalit Rajonal Fier, duke përditësuar funksionet e strukturës së arkiv-protokollit dhe duke përcaktuar saktë varësinë institucionale të kësaj strukture. Gjithashtu nga drejtoria të merren masa për informatizimin e dokumentacionit arkivor në bashkëpunim me protokollin, me synim krijimin e një databaze të rregullt të të dhënave për shmangien e parregullsive në mbajtjen e dokumentacionit të protokoll-arkivës në këtë subjekt.

Në vijimësi

9. Nga auditimi i realizimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

9.1.Gjetje nga auditimi: KLSH me shkresën përcjellëse me nr. 350/15, datë 5.10.2016 dhe me shkresën nr. 350/28, datë 26.12.2016 ka rekomanduar 36 masa gjithsej, nga këto: 18 masa organizative, 10 masa zhdëmtimi me vlerën 15,076.0 mijë lekë dhe 8 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Masa organizative: Janë rekomanduar 17, nga të cilat janë pranuar 17 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5, janë në proces 9, është zbatuar pjesërisht 1 dhe 2 nuk janë zbatuar.

b. Masa për shpërblim dëmi: Janë rekomanduar 10 masa në vlerën 15,076 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, 8 janë në proces dhe 2 nuk janë zbatuar.

c. Masa me karakter disiplinor. Janë rekomanduar 8 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar 8 ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar 8. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi:

Nga Spitali Rajonal Fier, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “F...” shpk, me objekt blerje “Defibrilator me monitor pacienti NIHON KOHDEN TEC-7721K” për vlerën 900,000 lekë, viti 2016, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet mjekësore nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e testraportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F...” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të jap opinion e Tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmoj që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Nga Drejtoria të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve .

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “F...” shpk, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 900,000 lekë** nga Shoqëria “F...” shpk.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:

Kontrata nr. 2454 prot., datë 13.09.2016 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjete viti 2016”, ka shërbime të dubluara (pagesë të dubluar) me kontratën nr. 484, datë 27.01.2017, lidhur me shoqërinë “A.....” për vlerën 257,520 lekë. **Vlera 257,520 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Spitalit Rajonal Fier dhe Buxhetit të Shtetit**, i krijuar për periudhën Janar-Mars 2017, vlerë e cila duhet të zhdëmtohet nga shoqëria “A.....” . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 77 “Mbikqyrja e kontratës” të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e regullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **257,520 lekë** nga

shoqëria “A....”. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitimin pa të drejtë të kësaj shume nga ky operator, pasi ka shërbime të dubluara (pagesë të dubluar) për pjesët e ndërruara të automjeteve, të cilat janë brenda periudhës së garancisë së kontratës.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Shpenzime mirëmbajtje automjete 2017”, u konstatua se kjo kontratë nuk është zbatuar plotësisht. Konkretisht:

-Nuk ka aktkonstatim të evidentimit të difekteve të automjeteve të firmosur nga personat përgjegjës, si dhe kartela të shërbimit për çdo automjet.

-Nga kryqëzimi i të dhënave ndërmjet dokumentacionit të mbajtur për riparimin e automjeteve dhe të dhënave të GPS të instaluar në makinat e Spitali Rajonal Fier, rezulton se në ditën kur është kryer riparimi i automjeteve, automjetet kanë qenë në lëvizje, çka nuk vërteton plotësisht kryerjen e riparimeve atë ditë.

-Referuar fletëhyrjes së magazinës nr. 2, datë 27.12.2017, të gjitha pjesët rikupero të rezultuara nga shërbimi i automjeteve, janë bërë hyrje në magazinë me një diferencë në vlerën 676,680 lekë.

Veprim në kundërshtim me kontratën e lidhur nga palët me nr. 3035 prot, datë 07.12.2017, seksioni “Të drejtat dhe detyrimet e të porositurit”, pika 11, ku në mënyrë eksplicite është përcaktuar se: *“I porosituri është i detyruar t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha pjesët e ndërruara pas çdo shërbimi të kryer”,* si dhe tek “Marrja në dorëzim” pika 2 saktësohet e njëjta gjë si më sipër.

Për pasojë vlera prej 676,680 lekë, konsiderohet pagesë e kryer për shërbime të paofruara nga operatori ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës” të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. ***Vlera 676,680 lekë përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A....”.*** (Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **676,680 lekë** nga operatori ekonomik “A.....”. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitimin pa të drejtë të kësaj shume nga ky operator, pasi nga auditimi nuk provohet plotësisht (nuk ka dokumentacion justifikues) që këto shërbime janë kryer.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstrukcion i KUZ”, u konstatua se është financuar kontraktori “S....” sh.p.k, për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer vlerën **105,840 lekë**, e për pasojë është shkaktuar një **dëm ekonomik** për Spitalin Rajonal Fier dhe

Buxhetin e Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **105,840 lekë** nga operatori ekonomik “S...”. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitimin pa të drejtë të kësaj shume nga ky operator, si pasojë e zërave punimesh të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kontratën nr. 1607, datë 03.05.2017 me objekt “Blerje e medikamentit Glukozë dhe Sodium Chloride” (Tender i Përqendruar), përkatësisht 1,000 njësi dhe 67,500 njësi e lidhur midis Spitali Rajonal Fier dhe A Sh.p.k, me vlerë 5,671,253 lekë, u konstatua mos lëvrimit malli sipas afateve në kundërshtim me kontratën nr. 1607, datë 03.05.2017, me objekt “Blerje e medikamentit Glukozë dhe Sodium Chloride”, seksioni “Afati i lëvrimit” dhe “Të tjera”. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 776,323 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalit Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit. Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” dhe neni 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Spitali Rajonal Fier të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **776,323 lekë** nga Shoqëria “A.....” sh.p.k për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1607, datë 03.05.2017, me objekt “Blerje e medikamentit Glukozë dhe Sodium Chloride” (Tender i Përqendruar), përkatësisht 1,000 njësi dhe 67,500 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërisë “A.....” sh.p.k, vitit 2017, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi nuk ka respektuar afatet e lëvrimit të medikamenteve.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kontratën nr. 1352, date 17.05.2016, me objekt “Blerje e medikamentit Sodim chloride” (Tender i Përqendruar), 75,000 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe bashkimit të operatorëve “M.... & E....” me vlerë 5,748,000 lekë, u konstatua mos lëvrimit malli sipas afateve në kundërshtim me kontratën nr. 1352, datë 17.05.2016 me objekt “Blerje e medikamentit Sodim chloride” (Tender i Përqendruar), seksioni “Afati i lëvrimit” dhe “Të tjera”. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 404,199 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit. Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” dhe neni 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Spitali Rajonal Fier të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **404,199 lekë** nga bashkimi i operatorëve “M.... & E....”, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1352, datë 17.05.2016 me objekt “Blerje e medikamentit Sodim chloride” (Tender i përqendruar), 75,000 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe bashkimit të operatorëve “M.... & E....”,

viti 2016, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi nuk ka respektuar afatet e lëvrimit të medikamenteve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kontratën nr. 1456, datë 24.04.2017 me objekt “Blerje e medikamentit Cefazoline dhe Cefriazone” (Tender i Përqendruar), përkatësisht 22830 njësi dhe 8400 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërië “I” shpk me vlerë 2,207,640 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve, në kundërshtim me kontratën nr. 1456, datë 24.04.2017, seksioni “Afati i lëvrimit” dhe “Të tjera”. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 82,457 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit. Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” dhe neni 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Spitali Rajonal Fier të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **82,457 lekë** nga Shoqëria “I.....” shpk për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1456, date 24.04.2017, me objekt “Blerje e medikamentit Cefazoline dhe Cefriazone” (Tender i Përqendruar), përkatësisht 22830 njësi dhe 8400 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërisë “I.....” shpk, viti 2017, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi nuk ka respektuar afatet e lëvrimit të medikamenteve.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u konstatua se në 3 raste operatori ekonomik “M.....” shpk nuk ka zbatuar grafikun e lëvrimit të medikamenteve sipas kontratave, konkretisht:

- Për kontratën nr. 1022, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente flurosemid” (Tender i përqendruar), 13,000 njësi e lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërisë “M...”, shpk me vlerë 187,850 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve të kontratës. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 7,659 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

- Për kontratën nr. 1020, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente calcium dhe acid tranexamic” (Tender i përqendruar), lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërisë “M...”, shpk, me vlerë 354,700 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve të kontratës. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 14,024 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

- Për kontratën nr. 1024, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente metoclopramid dhe magnezium sulfate” (Tender i përqendruar), lidhur midis Spitalit Rajonal Fier dhe Shoqërisë “M...”, shpk me vlerë 512,310 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve të kontratës. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është 54,940 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

Mos lëvrimi i mallit sipas afateve të vendosura është në kundërshtim me kontratat e medikamenteve nr. 1022, nr. 1020, nr. 1024, datë 28.04.2016 për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për blerje medikamentesh, seksioni “Afati i lëvrimit” dhe “Të tjera”,

Veprime ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” dhe neni 60 “Rregullat që zbatohen

për kontratën”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Spitali Rajonal Fier të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **76,623 lekë** nga shoqëria “M.....” sh.p.k, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1022, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente flurosemid”, kontratën nr. 1020, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente calcium dhe acid tranexamic” dhe kontratën nr. 1024, datë 28.04.2016, me objekt “Blerje medikamente metoclopramid dhe magnezium sulfat”, viti 2016, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi nuk ka respektuar afatet e lëvrimit të medikamenteve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të medikamenteve për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u konstatua se në 2 raste operatori ekonomik “E.....”, nuk ka zbatuar grafikun e lëvrimit të medikamenteve sipas kontratave, konkretisht:

- Për kontratën nr. 1723, datë 16.05.2017, me objekt “Blerje medikamente Sodium bicarbonat Sodium Lactate dhe Sodium Chloride” (Tender i përqendruar), përkatësisht 10,000 njësi, 18,300 njësi dhe 1,400 njësi, me vlerë 2,371,760 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve të kontratës. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është në vlerën 46,753 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

- Për kontratën nr. 1912, datë 06.06.2017, me objekt “Blerje medikamenti Fentanyl” (Tender i përqendruar), 1070 njësi me vlerë 128,400 lekë, u konstatua mos lëvrim malli sipas afateve të kontratës. Penaliteti i llogaritur dhe i pa mbajtur është në vlerën 23,909 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

Mos lëvrimi i mallit sipas afateve të vendosura, është në kundërshtim me kontratat e medikamenteve nr. 1723, datë 16.05.2017 dhe nr. 1912, datë 06.06.2017 për prokurimet e përqendruara të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për blerje medikamentesh, seksioni “Afati i lëvrimit” dhe “Të tjera”, si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës” dhe neni 60 “Rregullat që zbatohen për kontratën”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Spitali Rajonal Fier të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **70,662 lekë** nga Shoqëria “E.....” shpk, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 1723, datë 16.05.2017, me objekt “Blerje medikamente Sodium bicarbonat Sodium Lactate dhe Sodium Chloride”, dhe kontratën nr. 1912, datë 06.06.2017, me objekt “Blerje medikamenti Fentanyl”, viti 2017, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri, pasi nuk ka respektuar afatet e lëvrimit të medikamenteve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, është shpenzuar karburant për automjetet e Spitalit në sasinë 6 606 litra me vlerë 1,050,481 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht fletë-udhëtimet nuk përputhen me distancën e dokumentuar nga GPS nga rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjeti etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.

10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke krijuar në këtë mënyrë për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit një **dëm ekonomik** në vlerën 1,050,481 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 25-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Nga drejtorja të shqyrtohet vlera **1,050,481 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet për karburant për automjetet e Spitalit, për të cilat nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Fier ka lidhur kontratën e qirasë nr. 525, datë 21.03.2013, me objekt dhënien me qira të hapësirës 30 m², me vlerë 5,400 lekë në muaj (30 m² x 180 lekë/m²), me afat 1 vit. Me mbarimin e afatit të kontratës, nga Spitali Rajonal Fier është lejuar që personin fizik F.B, ta posedojë ambientin, pa nënshkruar më parë kontratë të re qiraje, në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 801-825, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”. Nga verifikimi në terren (datë 17.04.2018) konstatohet se ky ambient është akoma në përdorim nga personin fizik F.B Për pasojë, detyrimi i qirasë për periudhën 01.04.2016-31.12.2017 **në vlerën 199,800 lekë** (21 muaj x 5,400 lekë në muaj+ detyrimi i mbartur për periudhën e mëparshme objekt auditimi në vlerën 86,400 lekë), **përbën dëm ekonomik për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit**. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 124-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: -Nga Drejtorja e Spitalit Rajonal Fier, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik **në vlerën 199,800 lekë** nga personin fizik F.B

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

B.2.1. Gjetje nga auditimi:

Në Spitalin Rajonal të Fierit, janë instaluar pajisje për sistemin “E-health” që në datën 24.05.2016, pajisje të cilat shërbejnë për të modernizuar dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore (Pra u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Çka do të thotë që çdo qytetar që paraqitet në dyert e këtij spitali, ka të informatizuar të gjithë të dhënat e vizitës dhe përmbledhjen e daljes në çdo

spital tjetër, ku është vizituar apo kuruar). Deri më datën 20.04.2018, datë në të cilën ka përfunduar auditimi, këto pajisje nuk janë vënë plotësisht në funksion.

Mos vënia në punë të këtij sistemi me vlerë pajisjesh 32,451,044 lekë për Spitalin Rajonal Fier, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij investimi, që ka të bëjë me modernizimin dhe përmirësimin e kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore.

Në opinionin tonë:

Nga drejtuesit e Spitalit Rajonal Fier, nuk është trajtuar seriozisht implementimi i projektit “Shëndetësia elektronike”, duke mos e monitoruar pothuajse asnjëherë situatën dhe ecurinë e projektit, e cila është në një gjendje mjaft shqetësuese. Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të drejtuesve të Spitalit Rajonal Fier, aktualisht mund të themi së implementimi i këtij projekti ka dështuar.

Për pasojë, deri në vënien në funksion të plotë të sistemit, vlera 32,451,044 lekë përbën efekt financiar negativ për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit nëse projekti vazhdon të mos implementohet.

Këto pajisje janë përfituar nëpërmjet projektit “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar” me numër kontrate ALB2012, miratuar me Ligjin nr. 69/2014 datë 03.07.2014, ku është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, marrëveshja e kredisë së eksportit si hua e butë me nr. 232,324, për një shumë maksimale prej 13,995,000 euro. Palët në këtë marrëveshje janë: Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave e cilësuar si “Huamarrës” dhe U. A. AG e cilësuar si “Huadhënës”.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi B.Ç me detyrë ish-drejtor i spitalit në periudhën 30.03.2016 deri 14.06.2017, A.D me detyrë ish-drejtor i spitalit për periudhën 15.06.2017 deri 06.12.2017, N.SH me detyrë Drejtor i Spitalit Rajonal Fier për periudhën 07.12.2017 e në vazhdim. (Trajtuar më hollësisht në faqet 132-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:

Nga drejtoria të shqyrtohet vlera **32,451,044 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos vënien plotësisht në funksion të pajisjeve për sistemin “E-health”, të cilat shërbejnë për të modernizuar dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore. Të evidentohen përgjegjësitë, të merret vendimi përkatës si dhe të merren masa të menjëhershme për vënien në funksionim të sistemit “E-health”, pasi vlera **32,451,044 lekë** përbën efekt financiar negativ për Spitalin Rajonal Fier dhe Buxhetin e Shtetit, nëse projekti vazhdon të mos implementohet.

Në rast të mos zbatimit të këtij rekomandimi, KLSH do ta konsiderojë dëm ekonomik vlerën **32,451,044 lekë** dhe do të denoncojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë realizuar mos përmbushjen e rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të Spitalit Rajonal Fier dhe të Shtetit, si dhe do të kërkojë dëmshpërblimin e kësaj vlere në zbatim të neneve 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda 2 muajve

B.2.2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, Spitali Rajonal Fier është penalizuar nga vendimet e

gjykatave në vlerën **1,524,161 lekë** lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqet 22-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Nga drejtoria të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për Institucionin, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Në vijimësi

B.2.3. Gjetje nga auditimi:

Në 11 raste në vlerën **2,347,141 lekë** janë kryer procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (shtesa kontrate 20%), në rrethanat të veçanta (kushte specifike) të pa parashikuara nga dispozitat ligjore, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”. Vlera **2,347,141 lekë** përbën efekt financiar negativ për buxhetin e vitit 2017, pasi ka rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të panevojshme shpenzimet e këtij viti buxhetor. (Trajtuar më hollësisht në faqet 41-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Nga drejtoria të analizohet vlera **2,347,141 lekë**, e cila përbën efekt financiar negativ për vitin buxhetor 2017, si dhe në vazhdimësi të merren masa për kryerjen e vetëm atyre shtesave të kontratave të cilat janë të domosdoshme për ecurinë normale dhe përmbushjen e nevojave spitalore, deri në nënshkrimin e kontratave, duke verifikuar paraprakisht gjendjen në magazinë e duke e krahasuar atë me konsumin mujor të spitalit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 3197 prot., datë 05.04.2016, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit marrjen e masave disiplinore ndaj personelit, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë nga Kontrolli i Lartë të Shtetit në zbatim shkresave nr. 350/15, datë 5.10.2016 dhe me shkresën nr. 350/28, datë 26.12.2016.

C.2. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, për personat që nuk janë më në detyrën e drejtorit të Spitalit Rajonal Fier, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“Kalim në një detyrë apo klasë më të ulët për një periudhë nga 30 ditë deri në një vit”
për:

1. A.D me detyrë ish-drejtor i Spitalit Rajonal Fier për periudhën 15.06.2017 deri në 06.12.2017, kjo masë konsiderohet e ezauruar pasi është liruar nga detyra.

2. B.Ç me detyrë ish-drejtor i Spitalit Rajonal Fier për periudhën 01.04.2016 deri në 15.06.2017, kjo masë konsiderohet e ezauruar pasi është liruar nga detyra.

D. TË TJERA

Për statusin juridik të Spitalit Rajonal Fier, trajtuar në Masën Organizative A.1.1 do ti drejtohem edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi nga auditimi i kryer në Spitalin Rajonal Fier u konstatua që:

1.1 Gjetje nga auditimi: Mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë të Spitalit Rajonal Fier, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre është me status të pa përcaktuar. Konkretisht:

Spitali Rajonal Fier është person juridik publik dhe organizohet, administrohet dhe vepron sipas Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, si edhe të gjitha ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore për shërbimin spitalor dhe kujdesin shëndetësor.

Në mbështetje të këtij ligji, ky spital kategorizohet *de jure* si spital rajonal (spital qarku) dhe emërtimi specifik i tij është “Spitali Rajonal Fier”. Organet drejtuese të autoritetit spitalor të qarkut duhet të jenë 1. Këshilli Administrativ; 2. Drejtoria; 3. Komisioni mjekësor. Ndërkohë që faktikisht në këtë qendër funksionon vetëm Drejtoria, ndërsa organet kolegjiale Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor nuk funksionojnë.

Drejtoria sipas përcaktimeve në ligj është e përbërë prej 1. Drejtori ekzekutiv; 2. Zëvendësdrejtori teknik 3. Zëvendësdrejtori ekonomik; 4. Kryeinfermieri i përgjithshëm. *De facto* titullari i institucionit nuk është drejtor ekzekutiv me të drejta dhe kompetenca të plota, pikërisht prej boshllëkut të krijuar strukturalist, për shkak të mungesës së organeve të përcaktuara në ligj, me të cilët janë të lidhura ngushtësisht detyrat ekzekutive të titullarit.

Neni 40 i ligjit parashikon: “*Pranë autoritetit spitalor publik të qarkut ushtron veprimtarinë e vet komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut, i cili është organi këshillimor i tij*”, në fakt një komitet i tillë nuk ekziston.

Në këto kushte është i pamundur përcaktimi konkret i statusit juridik të Spitalit Rajonal Fier.

Për më tepër konfuziteti dhe hendeuku i madh që ekziston mes referimit në ligj dhe asaj çfarë ndodh në përditshmërinë e aktivitetit spitalor provohet dhe me faktet si më poshtë:

-Kategorizimi i pagave të personelit administrativ dhe atij spitalor të kësaj qendre, e cila konsiderohet Spital Rajonal, është i njëjtë me të gjitha spitalet e tjera të bashkive të Qarkut të Fierit, Bashkia Fier, Bashkia Lushnje, Bashkia Mallakastër, Bashkia Divjake, Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec. Më konkretisht, titullari i institucionit (drejtori) baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 81,800 lekë, mjek i përgjithshëm baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 42,000 lekë, shërbimi baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 55,000 lekë, specialist i thjeshtë i administratës baza e pagës së funksionit në të dy nivelet e spitaleve është 34,200 lekë; etj.

-Transaksionet financiare të kryera nga Dega e Thesarit pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, emërtohen për llogari të Spitalit të Rrethit (Bashkisë) Fier. Pra, Spitali Rajonal Fier kategorizohet në të njëjtin rang juridik si spitalet e tjera të nivelit bashkiak.

-Struktura analitike, organizative dhe administrative, e cila vjen e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë është e njëjtë si për Spitalin Rajonal Fier që ligjërisht organizohet si Spital Rajonal, ashtu edhe për Spitalet e Qarkut të Fierit që organizohen si spitale bashkiake.

-Miratimi i tarifave të shërbimeve bëhet me urdhër të brendshëm të titullarit të Institucionit (Drejtori), në mungesë të Këshillit Administrativ; etj.

Bazuar në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, organi përgjegjës për njohjen, hapjen dhe klasifikimin e spitaleve publike, miratimin e strukturës organike, ofrimit të llojeve të shërbimeve spitalore, etj, është Ministria

e Shëndetësisë, e cila duhet të bëjë një përcaktim juridik në lidhje me statusin juridik të spitaleve publike, përfshirë edhe Spitalin Rajonal Fier.

-Veprimtaria e administratës është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, që miratohet nga Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu dhe Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë të urdhërojë ushtrimin e kontrolleve të plota ose të pjesshme për veprimtarinë e Spitalit Rajonal Fier nëpërmjet strukturave të specializuara. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandimi:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të përcaktojë statusin juridik të Spitalit Rajonal Fier, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e këtij spitali.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R